



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 24 prill 2020
Nr. Ref.:RK 1552/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI42/18

Parashtrues

Asija Muslija

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit KMLC nr. 09/2018 të
Prokurorit të Shtetit, të 2 marsit 2018
dhe Aktvendimit AC. nr. 3538/2017
të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, të 8 dhjetorit 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Asija Muslija, nga Komuna e Prizrenit (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Njoftimin [KMLC. nr. 09/2018] e 2 marsit 2018 të Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Prokuroria e Shtetit) dhe Aktvendimin [AC. nr. 3538/2017] e 8 dhjetorit 2017 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Njoftimit dhe Aktvendimit të lartcekur përmes të cilave, sipas pretendimit, parashtrueses së kërkesës iu janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 5 [Gjuhët], 24 [Barazia para ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura para Gjykatës

6. Më 27 mars 2018, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 29 mars 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Selvete Gërzhaliu-Krasniqi.
8. Më 5 prill 2018, Gjykata njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që të plotësojë formularin zyrtar të Gjykatës ose ekuivalentin e tij dhe të dorëzojë në Gjykatë, Aktvendimin të Gjykatës Themelore në Prizren (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) dhe të cilit iu kishte referuar në kërkesën fillestare, por nuk e kishte dorëzuar në Gjykatë.
9. Më 30 prill 2018, parashtruesja e kërkesës dorëzoi dokumentet e kërkuara në Gjykatë.

10. Më 7 maj 2018, parashtruesja e kërkesës dorëzoi edhe një dokument tjetër shtesë në Gjykatë.
11. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.
12. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
13. Më 20 qershor 2019, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit dhe Prokurorisë së Shtetit.
14. Më 26 qershor 2019, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore që të dorëzojë një kopje të të gjithë dosjes në Gjykatë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga pranimi i shkresës së Gjykatës. Brenda afatit të përcaktuar, Gjykata nuk pranoi dosjen e kërkuar nga Gjykata Themelore.
15. Më 3 korrik 2019, duke qenë se katër gjyqtarëve të lartpërmendur u kaloi mandati i tyre si gjyqtarë të Gjykatës, Kryetarja e Gjykatës, në bazë të Ligjit dhe Rregullores së punës, nxorri Vendimin Nr.GJK.42/18 për zëvendësimin e gjyqtarëve të Kolegjit shqyrtues, dhe ky i fundit u përcaktua në përbërje të: Selvete Gërxhaliu Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Radomir Laban.
16. Më 25 korrik 2019, Gjykata i dërgoi Gjykatës Themelore një kërkesë të përsëritur për dorëzimin e kopjes së dosjes së plotë që ndërlihet me kërkesën e dorëzuar në Gjykatë, KI42/18. Gjykata ia rikujtoi Gjykatës Themelore detyrimin e tyre për përgjigje ndaj kërkesave të saj të përcaktuar përmes nenit 26 [Bashkëpunimi me organet tjera publike] të Ligjit. Gjykata përcaktoi një afat shtesë prej 7 (shtatë) ditësh për dorëzimin e kopjes së plotë të dosjes në fjalë.
17. Më 15 gusht 2019, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë kopjen e dosjes së kërkuar.
18. Më 28 gusht 2019, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës palëve të interesuara H.M. dhe Degës në Prizren të ProCredit Bank Kosova (në tekstin e mëtejme: ProCredit Bank), që të dyja palë të paditura nga parashtruesja e kërkesës në procedurat para gjykatave të rregullta. Me atë rast, Gjykata iu dha mundësinë palëve të interesuara që të paraqesin komentet e tyre lidhur me kërkesën, nëse kanë, brenda një afati prej 7 (shtatë) ditëve nga pranimi i shkresës së Gjykatës.
19. Më 6 shtator 2019, Gjykata pranoi disa komente nga ProCredit Bank, e të cilat reflektohen në paragrafët 47-52 të këtij Aktvendimi. Brenda afatit të përcaktuar, Gjykata nuk pranoi ndonjë koment nga pala e interesuar H.M.
20. Më 6 mars 2020, Zëvendës Kryetari i Gjykatës, gjyqtari Bajrami Latifi, bazuar në nënparagrafin 1.2 të paragrafit 1 të nenit 18 (Përjashtimi i gjyqtarit) të Ligjit

dhe rregullin 9 (Procedurat për përjashtim) të Rregullores së punës, kërkoi përjashtimin nga vendimmarrja në rastin KI42/18.

21. Më 11 mars 2020, Kryetarja e Gjykatës aprovoi kërkesën e lartcekur, dhe bazuar në paragrafin 4 të rregullit 9 të Rregullores së punës, ky vendim i komunikua të gjithë gjyqtarëve.
22. Më 11 mars 2020, Gjykata shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

23. Më 2 dhjetor 2011, H.M. [bashkëshorti i parashtrueses së kërkesës] dhe A.M. [vëllai i H.M.-së], në cilësi të hipoteklënësve, nënshkruan me ProCredit Bank-ën, një Kontratë për Hipotekën, në të cilën në hipotekë u la ngastra kadastrale P-71813068-07517-2 me sipërfaqe të përgjithshme prej 319 m² dhe e cila, sipas shkresave të lëndës, evidentohet në emër të H.M. në pjesë prej 1/3-tës (një të tretës) dhe në emër të A.M. në pjesë prej 1/3-tës (një të tretës). Në Kontratën në fjalë, A.M. dhe H.M. u cilësuan si hipotekëlënësi i parë dhe i dytë, respektivisht. Bashkëshortet e tyre, përfshirë parashtruesen e kërkesës nuk e kishin nënshkruar Kontratën e Hipotekës.
24. Më 5 dhjetor 2011, Kontrata mbi Hipotekën ishte regjistruar në Regjistrin e të Drejtave të Pronave të Paluajtshme përmes Aktvendimit [Nr.07-027-13612/H] të Zyrës Komonale të Kadastrit në Prizren.
25. Më 6 dhjetor 2011, H.M si kredimarrës dhe A.M., e R.M. dhe A.M, përkatësisht vëllau i tij dhe bashkëshortet e tyre, përfshirë parashtruesen e kërkesës, si bashkë-kredimarrës kishin nënshkruar Kontratën e Kredisë. Bazuar në shkresat e lëndës, kjo Kontratë kredie dhe e pengut ishte amendamentuar më 24 nëntor 2014 dhe 28 prill 2015, respektivisht, amendamente këto përmes të cilave ishte ristrukturuar borxhi kryesor, interesi dhe plani i pagesave të kredisë. Bashkëshortet R.M. e A.M., përfshirë parashtruesen e kërkesës, kishin nënshkruar gjithashtu në cilësi të bashkë-huamarrëseve.
26. Më 19 janar 2016, sipas shkresave të lëndës dhe marrë parasysh që Kontrata e Kredisë nuk ishte respektuar nga kredi-marrësit, rrjedhimisht edhe nga bashkë-huamarrëset, ProCredit Bank iu drejtua Përmbaruesit Privat me propozim për përbarim.
27. Më 1 qershor 2016, Përmbaruesi Privat nxjerri Konkluzionin [P.nr.10/2016] përmes të cilit caktoi shitjen e paluajtshmërisë të lënë në hipotekë, duke e përcaktuar seancën e parë për shitje, më 1 korrik 2016.
28. Më 30 qershor 2016, parashtruesja e kërkesës paraqiti padi kundër H.M., përkatësisht bashkëshortit të saj, si i padituri i parë, dhe ProCredit Bank-ës, si e paditura e dytë, me kërkesë për anulimin e Kontratës së lartpërmendur të Hipotekës dhe vërtetimit të pronësisë së saj mbi ngastrën përkatëse kadastrale, si bashkëshorte e H.M.-së. Në arsyetim të padisë së saj, parashtruesja e kërkesës theksoi se bashkëshorti i saj kishte vepruar pa dijeninë e saj, kur e

kishte vendosur në hipotekë pronën e tyre të përbashkët. Si rrjedhojë, parashtruesja e kërkesës kërkoi nga Gjykata Themelore që të (i) caktojë masën e përkohshme të sigurimit, përmes së cilës do të ndërprehen të gjitha veprimet përmbarese në procedurën e përmbarimit; (ii) miratojë kërkesëpadinë; (iii) vërtetojë pronësinë e saj për pronën/paluajtshmërinë e cila është vendosur në hipotekë; (iv) urdhërojë organet kadastrale që të ndërmarrin hapat e nevojshëm në përputhje me vendimin e Gjykatës Themelore; dhe, (v) shpallë nule dhe të pavlefshme Kontratën për Hipotekën të 2 dhjetorit 2011.

29. Më 14 korrik 2016, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [C.nr.651/16], e aprovoi si të bazuar propozimin e parashtrueses së kërkesës për caktim të masës së përkohshme të sigurimit dhe ia ndaloi ProCredit Bank-ës që të realizojë të drejtën e saj si kreditore dhe të shesë paluajtshmërinë e lënë në hipotekë, përmes Kontratës për Hipotekë. Gjykata Themelore e arsyetoi miratimin e këtij propozimi, me faktin se ka bazë të besohet se pa caktimin e kësaj mase *“do të vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesëpadisë nga pala paditëse, i paraparë me nenin 297.1 pik.b, të LPK”* dhe se ekziston rreziku *“real se pa caktimin e masës së përkohshme të propozuar, pala paditëse [parashtruesja e kërkesës] do të mund të pësojë dëm të pariparueshëm.”*
30. Më 22 dhe 27 korrik 2016, respektivisht, ProCredit Bank paraqiti (i) kundërshtimin e saj ndaj Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore përkitazi me masën e përkohshme të sigurimit, duke theksuar, ndër tjerash, se paditësja, përkatësisht parashtruesja e kërkesës, ka nënshkruar marrëveshjen mbi kredinë dhe amendamentet pasuese, në cilësi të bashkë-huamarrëses, dhe se paluajtshmëria përkatëse është regjistruar në regjistrin e hipotekës përmes Aktvendimit të Kadastrit Komunal në Prizren; dhe (ii) përgjegje në padinë e parashtrueses së kërkesës të 30 qershorit 2016, duke kërkuar nga Gjykata Themelore që padinë e paditëses, përkatësisht parashtrueses së kërkesës, ta refuzojë si të pabazuar.
31. Në ndërkohë, akoma pa u vendosur mbi kundërshtimin e lartcekur të ProCredit Bank-ës në lidhje me caktimin e masës së sigurimit, më 26 shtator 2016, Gjykata Themelore, përmes një Aktvendimi tjetër me të njëjtin numër [C.nr.651/16], vendosi që padia e parashtrueses së kërkesës duhet të konsiderohet si të tërhequr. Kjo për faktin se parashtruesja e kërkesës, ndonëse e njoftuar në mënyrë të rregullt për seancën kryesore ku do të shqyrtohej padia e saj, nuk ishte paraqitur në Gjykatën Themelore dhe, sipas kësaj të fundit, bazuar në paragrafin 3 të nenit 423 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK), në rastet kur *“paditësi nuk vjen në seancë kryesore edhe pse është thirrur në rregull”*, padia konsiderohet si e tërhequr.
32. Më 19 dhjetor 2016, parashtruesja e kërkesës paraqiti një kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme në Gjykatën Themelore, duke kërkuar që të shfuqizohet Aktvendimi i lartcekur i Gjykatës Themelore përmes së cilës padia e saj ishte konsideruar si e tërhequr dhe të vazhdohet me shqyrtimin e padisë së saj.
33. Më 28 dhjetor 2016, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit tjetër, që poashtu mban të njëjtin numër [C.nr.651/16], e aprovoi si të bazuar kërkesën e

parashtrueses së kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme dhe e prishi Aktvendimin e saj të mëhershëm përmes së cilit padia ishte konsideruar si e tërhequr. Përmes këtij Aktvendimi, Gjykata Themelore theksoi se *“procesi kontestimor në këtë çështje juridike kthehet në atë gjendje në të cilën ndodhej para mosveprimit.”* Gjykata Themelore vlerësoi se kërkesa e parashtrueses për kthim në gjendje të mëparshme ishte e justifikueshme ngase është vërtetuar se pala nuk ka qenë e informuar mirë dhe se për rrjedhojë ekzistojnë shkaqet e përcaktuara me nenin 129 të LPK-së, sipas së cilave, kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme duhet të miratohet. Nga shkresat e lëndës rezulton që ky Aktvendim i Gjykatës ishte përpiluar në gjuhën boshnjake dhe shqipe.

34. Më 23 shkurt 2017, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit që mban të njëjtin numër me tri Aktvendimet e tjera të lartcekura, përkatësisht [C.nr.651/16], shqyrtoi kundërshtimin e paraqitur nga ProCredit Bank më 22 korrik 2016 dhe e anuloi masën e përkohshme të sigurimit të vendosur më 14 korrik 2016, pasi kishte vërtetuar përmes kundërshtimit të ProCredit Bank-ës se parashtruesja e kërkesës në fakt kishte nënshkruar Kontratën e Kredisë në cilësinë e bashkë-huamarrëses. Ky Aktvendim, përtej anulimit të masës së përkohshme të sigurimit, theksoi se procedura kontestimore e iniciuar sipas padisë të 30 qershorit 2017, do të vazhdojë bazuar në dispozitat e LPK-së.
35. Kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën e saj dhe ta prishë Aktvendimin e Gjykatës Themelore, duke e kthyer çështjen në rivendosje.
36. Më 8 dhjetor 2017, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin [AC.nr.3538/2017], përmes së cilit e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe e vërtetoi Aktvendimin [C.nr.651/16] e 23 shkurtit 2017 të Gjykatës Themelore.
37. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesja e kërkesës iu drejtua Prokurorit të Shtetit me kërkesën që të paraqitet kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë për rastin e saj. Ajo po ashtu u ankua që Aktvendimi [AC. nr. 3538/2017] i Gjykatës së Apelit nuk iu ishte dorëzuar në gjuhën e saj amtare, respektivisht atë boshnjake.
38. Më 2 mars 2018, Prokurori i Shtetit përmes parashtresës [KMLC. nr. 09/2018] e njoftoi parashtruesen e kërkesës që pas pranimit të propozimit të saj, Prokuroria e Shtetit i ka kërkuar të gjitha shkresat e lëndës nga Gjykata Themelore dhe pas shqyrtimit të tyre ka ardhur në përfundimin se nuk ka *“bazë të mjaftueshme, nga neni 247, paragrafi 1, pika a) dhe b) të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, për të parashtruar këtë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.”* Më tutje, lidhur me pretendimet e parashtrueses së kërkesës për dorëzim të vendimit në gjuhën e saj, respektivisht atë boshnjake, Prokurori i Shtetit kishte theksuar: *“Në lidhje me mos-dorëzimin e vendimit të Gjykatës së Apelit në gjuhën tuaj, ju mund ti drejtoheni Gjykatës Themelore në Prizren me kërkesën që vendimi të ju përkthehet.”*

39. Deri më sot, sipas informacioneve që Gjykata ka në dispozicion, gjykatat e rregullta kanë vendosur vetëm mbi kërkesën e parashtrueses së kërkesës për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, ndërsa padia e saj fillestare është akoma në shqyrtim pranë Gjykatës Themelore.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

40. Parashtruesja e kërkesës pretendon që Njoftimi [KMLC. nr. 09/2018] i 2 marsit 2018 i Prokurorit të Shtetit dhe Aktvendimi [AC.nr.3538/2017] i 8 dhjetorit 2017 i Gjykatës së Apelit, janë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të saj të garantuara përmes neneve 5 [Gjuhët], 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
41. Parashtruesja e kërkesës e konteston Njoftimin e lartcekur të Prokurorit të Shtetit, duke pretenduar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të (i) mungesës së arsytimit, përkatësisht "*arsyetimit kontradiktor*"; dhe (ii) mos shqyrtimit të dëshmive në mbështetje të propozimit për iniciimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë. Parashtruesja e kërkesës në këtë kontekst specifikisht pretendon se Prokurori i Shtetit ka qenë i detyruar të shqyrtojë dëshmitë e saj në mbështetje të propozimit për iniciimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe jo ta udhëzojë parashtruesen e kërkesës t'i drejtohet Gjykatës Themelore me kërkesë për përkthim të Aktvendimit të kontestuar duke theksuar si në vijim: "*Në lidhje me mos-dorëzimin e vendimit të Gjykatës së Apelit në gjuhën tuaj, ju mund të i drejtoheni Gjykatës Themelore në Prizren me kërkesën që vendimi të ju përkthehet*".
42. Në mbështetje të pretendimeve për mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor, parashtruesja e kërkesës i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), përkatësisht rastit *Hirvisaari kundër Finlandës*, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; ndërsa në mbështetje të pretendimeve për mosshqyrtimin e dëshmive të prezentuara nga parashtruesja e kërkesës në Prokurorinë e Shtetit, ajo i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përkatësisht rasteve *De Haes and Gijssels kundër Belgjikës*, Aktgjykim i 24 shkurtit 1997 dhe *Tinelly & Sons Ltd dhe të tjerët dhe McElduff dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 10 korrikut 1998.
43. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktvendimin e lartcekur të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar, në esencë, shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke theksuar se i njëjti nuk ka vërtetuar drejt gjendjen faktike, me theks në faktin që parashtruesja e kërkesës nuk e ka dhënë pëlqimin e saj për Kontratën e Hipotekës.
44. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të nenit 5 dhe 24 të Kushtetutës. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 5 të Kushtetutës, parashtruesja e kërkesës thekson se Gjykata e Apelit dhe Prokurori i Shtetit kanë vepruar në kundërshtim me nenin 5 të Kushtetutës, duke mos ia dorëzuar

vendimin përkatës në gjuhën e saj dhe duke mos marrë parasysh pretendimet lidhur me mosdorëzimin e vendimit në gjuhën e saj, respektivisht. Në kontekst të mosdorëzimit të Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit në gjuhën e saj amëtare, parashtruesja e kërkesës thekson se (i) për shkak të gjuhës *“nuk kam mundur që përmes përkthimit google translate të identifikoj faktet esenciale të cilat do t'i parashtroja në Propozimin të cilin ia kam dërguar Prokurorit Shtetëror për shkeljen e ligjshmërisë”*; dhe (ii) mos marrja parasysh e këtij fakti nga Prokurori i Shtetit ka rezultuar në *“shkelje absolute të të gjitha rregullave mbi përdorimin e gjuhës dhe aq më tepër të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, Kushtetutës së Kosovës, si dhe Konventës mbi të drejta e njeriut dhe liritë fundamentale.”*

45. Ndërsa, përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 24 të Kushtetutës, parashtruesja e kërkesës, në esencë thekson, se nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë me ProCredit Bank-ën, duke ngritur në esencë çështje që ndërlidhen me parimin e barazisë së armëve. Sipas pretendimit të parashtrueses së kërkesës, nëse Prokurori i Shtetit dhe gjykatat *“do të kishin marrë qasje strikte ligjore si ndaj meje ashtu edhe ndaj Bankës ProCredit nëse nuk ka pëlqim nga unë për hipotekën, nuk do të kish ardhë deri tek një paradoks i këtillë.”*
46. Në fund, parashtruesja e kërkesës, në esencë, kërkon nga Gjykata që ta shpallë kërkesën e saj të pranueshme dhe ta shpallë të pavlefshëm Njoftimin [KMLC. nr. 09/2018] e 2 marsit 2018 të Prokurorit të Shtetit dhe Aktvendimin [AC.nr.3538/2017] e 8 dhjetorit 2017 të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktvendimin [C.nr.651/16] e 23 shkurtit 2017 të Gjykatës Themelore, duke e kthyer çështjen e saj përkitazi me vendosjen e masës së përkohshme të sigurimit në rivendosje.

Komentet e ProCredit Bank

47. Lidhur me kërkesën në fjalë, ProCredit Bank kishte dorëzuar komente në Gjykatë, pas ftesës së kësaj të fundit. Në thelb, ProCredit Bank i kundërshtoi në tërësi të gjitha pretendimet e parashtrueses së kërkesës *“si të paarsyeshme dhe të pabazuara në ligj dhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.”*
48. Sipas ProCredit Bank, Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit [AC.nr.3538/2017] i 8 dhjetorit 2017 ka ardhë si rezultat i vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe se në rastin konkret *“nuk kemi të bëjmë me kurfarë shkelje”*. Më tutje, ProCredit Bank thekson se edhe parashtruesja e kërkesës por edhe vet dosja e rastit tregon se fillimisht Gjykata Themelore ia kishte miratuar asaj kërkesën për masë të sigurimit, mirëpo më vonë, pas kundërshtimeve të dorëzuara nga ProCredit Bank, Gjykata Themelore kishte mbajtur seancë dëgjimore dhe bazuar në provat e administruara kishte marrë një Aktvendim tjetër përmes së cilit kishte *“anuluar masën e përkohshme të sigurimit”*, të cilën e kishte vendosur Gjykata Themelore përmes vendimit të saj të parë.
49. Për sa i takon shkeljes së nenit 5 të Kushtetutës, ProCredit Bank thekson se, nuk qëndron pretendimi se *“palëve në procedurë u qenka mohuar e drejta e përdorimit të gjuhës sl tyre amëtare”*, ngase *“sikurse edhe vërtetohet edhe nga*

vet shkresat e lëndës, palët gjatë gjithë procedurës e kanë ushtruar të drejtën e tyre të përdorimit të gjuhës së tyre amtare në procedurë me çrast ata i kanë parashtruar të gjitha shkresat/parashtruesat në gjuhën e tyre amtare.” Për më tepër që, gjatë seancave të mbajtura, palëve në procedurë “u është siguruar çdo herë përkthyesi”, thekson ProCredit Bank. Kjo e fundit konsideron se palët në procedurë i kanë ushtruar të gjitha të drejtat e tyre dhe të gjitha mjetet juridike i kanë përdorur sipas ligjit në gjuhën e tyre amtare, andaj dhe gjykatat e rregullta kanë vendosur “në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.”

50. Për sa i takon shkeljes së neneve 24 dhe 31 të Kushtetutës, ProCredit Bank thekson se fakti që parashtruesja e kërkesës nuk ka pasur sukses në fund të procedurave gjyqësore ku është vendosur për masën e sigurimit dhe nuk ka qenë e kënaqur me vendimin për refuzimin e një mase të tillë, nuk do të thotë se ka pasur shkelje “përkitazi me barazinë para ligjit apo edhe të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.” Sipas ProCredit Bank-ës, të gjitha palëve në procedurë u janë siguruar dhe garantuar mbrojtje e barabartë e të drejtave dhe nuk qëndrojnë pretendimet e parashtrueses së kërkesës se ka pasur shkelje në këtë drejtim. ProCredit Bank po ashtu konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk ka arritur që me ndonjë provë të mbështesë pretendimet e saj për shkelje si të bazuara.
51. Për sa i takon pretendimit të parashtrueses së kërkesës se ajo nuk e ka dhënë pëlqimin për lënien e hipotekës, ProCredit Bank theksoi se nuk qëndron pretendimi i parashtruese se ajo “nuk ka dhënë pëlqimin për lënien në hipotekë të paluajtshmërisë”. Ajo, sipas ProCredit Bank-ës, ka qenë nënshkruese e marrëveshjes së kredisë, nr. 20044522 dhe se të gjitha këto fakte janë potencuar nga ProCredit Banka “gjatë zhvillimit të procedurës në këtë lëndë.”
52. Në fund, ProCredit Bank thekson me sa vijon: “Ne mendojmë se i vetmi qëllim i parashtrueses së kësaj ankese/kërkese është prolongimi i çështjes dhe se ata po tentojnë me çdo kusht që të prolongohet kthimi i obligimeve të cilat ajo së bashku me bashkëshortin e saj dhe debitorët tjerë i kanë ndaj nesh.” Në këtë drejtim, ProCredit Bank i propozoi Gjykatës që të refuzojë kërkesën e parashtrueses së kërkesës si të pabazaur.

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 5 [Gjuhët]

1. *Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe.*
2. *Gjuha Turke, Boshnjake dhe ajo Rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligj.*

Neni 24 **[Barazia para Ligjit]**

1. *Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
2. *Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
3. *Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.*

Neni 31 **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

1. *Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
2. *Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
(...)

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 **(E drejta për një process të rregullt)**

1. *Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.*
(...)

Ligji nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, publikuar në Gazetën Zyrtare më 20 shtator 2008, sipas ndryshimeve të bëra me Ligjin nr. 04/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, publikuar në Gazetën Zyrtare më 16 tetor 2012

**Neni 6
(i plotësuar dhe ndryshuar në vitin 2012)**

6.1. Në procedurën kontestimore gjuhët zyrtare përdoren në mënyrë të barabartë.

6.2. Procedura kontestimore zhvillohet në gjuhën që është në përdorim zyrtar në Gjykatë në pajtim me ligjin.

6.3. Çdo person që merr pjesë në procedurën kontestimore mund të përdor gjuhën zyrtare të cilën e zgjedh.

6.4. Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë, të cilët nuk e kuptojnë apo nuk flasin gjuhën që është në përdorim zyrtar në Gjykatë, kanë të drejtë që të përdorin gjuhën e vet apo gjuhën që e kuptojnë.

KREU VI

GJUHA NE PROCEDURË

Neni 96

96.1 Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë kanë të drejtë që në procedurën para gjykatës të përdorin gjuhën e vet apo gjuhën të cilën e kuptojnë.

96.2 Në qoftë se procedura nuk zhvillohet në gjuhën e palës, gjegjësisht të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë, do të sigurohet sipas kërkesës së tyre përkthimi gojarisht në gjuhën e tyre apo në gjuhën që e kuptojnë, i të gjitha parashtrësive dhe provave shkresore, si dhe i asaj që parashtrohet në seancë gjyqësore.

96.3 Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë do të njoftohen me të drejtën që procedurën verbale ta ndjekin në gjuhën e tyre me anë të përkthyesit. Ato mund të heqin dorë nga e drejta e përkthimit, po që se deklarojnë se e njohin gjuhën në të cilën zhvillohet procedura. Në procesverbal do të shënohet se u është dhënë udhëzimi për të drejtën e përdorimit të gjuhës së tyre, si dhe deklaratat e palëve dhe të pjesëmarrësve të tjerë lidhur me udhëzimin e dhënë nga gjykata.

96.4 Përkthimin e bëjnë përkthyesit.

96.5 Shpenzimet e përkthimit mbetën në ngarkim të buxhetit të gjykatës.

Neni 97

Letërthirrjet, vendimet dhe shkresat tjera gjyqësore u dërgohen palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurë në gjuhën që është në përdorimin zyrtar në gjykatë.

Neni 98

Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë i dërgojnë gjykatës paditë, ankesat dhe parashtrirat e tjera të tyre në gjuhën që është në përdorim zyrtar në gjykatë.

Neni 182

182.1 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston në qoftë se gjykata gjatë procedurës nuk e ka zbatuar apo ka zbatuar në mënyrë jo të drejtë ndonjë dispozitë të këtij ligji, kurse kjo ka pasur apo ka mundë të ketë ndikim në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm e të drejtë.

182.2 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë:

(...)

j) në qoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata e ka refuzuar kërkesën e palës, që në procedurë të përdorë gjuhën dhe shkrimin e vet e të ndjek procesin në gjuhën e vet, kurse për këtë arsye ankohet;

(...)

Neni 247

247.1 Prokurori shtetëror mund ta ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë:

a) për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, në qoftë se shkelja ka të bëjë me kompetencën territoriale, po qe se gjykata e shkallës së parë e ka nxjerrë aktgjykimin pa seancë kryesore, kurse e ka pasur detyrë ta mbajë seancën kryesore, po qe se është vendosur për kërkesën, rreth së cilës kontestimi është në vazhdim, apo në qoftë se në kundërshtim me ligjin, është përjashtuar publikuseancën kryesore;

b) për shkak të aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale.

247.2 Prokurori shtetëror nuk mundë të ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të kapërcimit të kërkesë-padisë dhe as për shkak të vërtetimit të gabueshëm apo jo të plotë të gjendjes faktike.

Ligji nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, publikuar në Gazetën Zyrtare më 1 mars 2007

Neni 12

(Përdorimi i gjuhëve në procedurat gjyqësore)

12.1. Gjuhët zyrtare përdoren në mënyrë të barabartë në procedurat gjyqësore.

12.2. Gjykatat dhe organet për ndjekje penale, si dhe autoritetet e tjera të përfshira në procedurë penale dhe në procedurat e tjera gjyqësore, sigurojnë që çdo person që merr pjesë në procedurat penale si dhe në

procedura të tjera gjyqësore mund të përdorë gjuhën zyrtare të cilën ai/ajo e zgjedh.

Neni 13

13.1. Gjykatat zhvillojnë procedurat në gjuhën zyrtare apo në gjuhët zyrtare të zgjedhura nga palët në procedura. Me kërkesën e palës në procedura, pajisjet duhet të sigurohen për përkthim simultan, duke përfshirë dëshmitë e dhëna, nga njëra gjuhë zyrtare në tjetrën.

13.2. Gjykatat mund të sigurojnë pajisjet për përkthim simultan të procedurave, duke përfshirë dëshmitë e dhëna, nga një gjuhë zyrtare në tjetrën, atëherë kur konsiderojnë se procedurat të jenë në interesin e përgjithshëm publik.

Neni 14

Gjykatat kanë për detyrë të lëshojnë dokumente të cilat kanë të bëjnë me procedurat në gjuhën (t) zyrtare të zgjedhur për procedurë dhe në gjuhë të tjera zyrtare nëse kërkohet nga cilado palë në procedurë apo nëse sipas pikëpamjes së gjykatës kjo do t'i shërbente interesit të përgjithshëm publik.

Neni 16

16.1. Çdo person që merr pjesë në procedurat penale dhe në procedura të tjera gjyqësore, i cili nuk flet ose nuk kupton gjuhën (t) e procedurave, ka të drejtë të përdorë gjuhën e tij apo të saj në procedura.

16.2. Personat që i takojnë komunitetit, gjuha amtare e të cilit nuk është gjuhë zyrtare dhe që marrin pjesë në procedura penale dhe procedurë penale dhe në procedurat tjera gjyqësore, kanë të drejtë të përdorin gjuhën e tyre amtare në procedura.

16.3. Gjykata dhe organet për ndjekje penale si dhe autoritetet e tjera të përfshira në procedurë penale, duhet të ofrojnë ndihmën me përkthyes pa pagesë për personat e cekur në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

Pranueshmëria e kërkesës

53. Gjykata së pari, shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.
54. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë,

mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

55. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

56. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata vlerëson se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar dhe konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Njoftimin [KMLC nr. 09/2018] e 2 marsit 2018 të Prokurorit të Shtetit dhe Aktvendimin [AC. nr. 3538/2017] e 8 dhjetorit 2017 të Gjykatës së Apelit, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ajo pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
57. Në vijim, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë të përcaktuara përmes Rregullores së saj të punës. Në këtë aspekt, Gjykata vëren së parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me pikat (a), (b), (c) dhe (d) të paragrafit 1 të rregullit 39.
58. Megjithatë, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata i referohet gjithashtu: (i) pikës (b) të paragrafit 3 të rregullit 39 të Rregullorës së punës, sipas të cilës, Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse e njëjta nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën; dhe (ii) paragrafit 2 të rregullit 39, e sipas të cilës, Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.
59. Vlerësimi i të parës në rrethanat e rastit konkret është i rëndësishëm sepse aktet e kontestuara dhe pretendimet e parashtrueses së kërkesës se të njëjtat janë nxjerrë në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, ndërlidhen me një kërkesë për një masë të sigurimit dhe rrjedhimisht, hyjnë në fushëveprimin e “*procedurave paraprake*”. Në raste të tilla, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e

Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në parim nuk janë të aplikueshme, përpos nëse rrethanat e rastit plotësojnë kritere të caktuara e të përcaktuara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe Gjykatës.

I. Përkitazi me pikën (b) të paragrafit 3 të Rregullit 39 të Rregullores së Punës

60. Gjykata, në këtë kontekst, fillimisht rikujton përmbajtjen e këtij rregulli si në vijim:

(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm:

[...]

(b) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;

61. Siç është cekur më lart, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata duhet të vlerësojë plotësimin e kritereve të përcaktuara përmes pikës (b) të paragrafit 3 të rregullit 39 të Rregullores së punës, sipas të cilës, Gjykata mund të konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse e njëjta nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën, sepse procedurat gjyqësore që kanë rezultuar në Njoftimin dhe Aktvendimin e kontestuar për objekt shqyrtimi kanë pasur një “*masë të përkohshme*” dhe rrjedhimisht kanë të bëjnë me “*procedura paraprake*”. Mbi bazën e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, neni 6 i KEDNJ-së, e në kontekst të Kushtetutës, neni 31 i saj, në parim, nuk janë të aplikueshme përkitazi me “*procedurat paraprake*”.
62. Rrjedhimisht, për të konstatuar nëse kjo kërkesë është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën, Gjykata fillimisht do t’i referohet parimeve të përgjithshme e të përcaktuara nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe praktika e Gjykatës sa i përket aplikueshmërisë së garancive procedurale të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së në rrethanat e rastit konkret, përkatësisht në “*procedurat paraprake*” dhe më pas do t’i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret, në mënyrë që të përcaktojë këtë aplikueshmëri.
63. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se parimet e përgjithshme përkitazi me aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së në “*procedurat paraprake*” janë përcaktuar nga Gjykata në rastet KI122/17, me parashtrues, *Ceska Exportni Banka A. S.*, Aktgjykim i 30 prillit 2018; dhe KI150/16, parashtrues *Mark Frrok Gjokaj*, Aktgjykim i 31 dhjetorit 2018. Parimet e përgjithshme të përcaktuara përmes këtyre dy Aktgjykimeve janë bazuar në rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës*, Aktgjykim i 15 tetorit 2009.
64. Gjykata thekson që praktika përkatëse e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës, sqaron parimet e përgjithshme mbi bazën e të cilave aplikueshmëria e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së në “*procedurat paraprake*”

është e kufizuar. Në përcaktimin nëse rrethanat e një rasti tejkalojnë këto kufizime, përkatësisht në përcaktimin nëse rrethanat e një rasti konkret përmbushin kriteret për aplikueshmërinë e garancive procedurale të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata duhet të aplikojë këto parime duke u mbështetur në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe kryesisht në rastin e lartcitur të GJEDNJ-së *Micallef kundër Maltës*.

65. Në këtë aspekt, Gjykata së pari rikujton se fushëveprimi i nenit 6 të KEDNJ-së shtrihet në procedurat që përcaktojnë të "*drejtat ose detyrimet civile*". (Shih rastin e GJEDNJ-së: *Ringelsen kundër Austrisë*, Aktgjykim i 22 qershorit 1972). Rrjedhimisht, për të qenë i aplikueshëm neni 6 i KEDNJ-së, rrethanat e një rasti duhet të ngërthejë një "*kontest*" në lidhje me një "*të drejtë civile*" dhe e cila, në parim, është e përcaktuar përmes ligjeve të aplikueshme. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 74; dhe rastin e Gjykatës KI150/16, parashtrues *Mark Frrok Gjokaj*, cituar më lart, paragrafi 63).
66. Gjykata më tutje thekson se, në parim, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, "*procedurat paraprake*", si ato që kanë të bëjnë me dhënien e një mase të përkohshme/mase të sigurimit, nuk konsiderohen që përcaktojnë të "*drejta dhe detyrime civile*" dhe për këtë arsye, në parim, nuk hynë në kuadër të fushëveprimit të mbrojtjes së tillë të nenit 6 të KEDNJ-së. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 75 dhe referencat e përdorura në të).
67. Megjithatë, përmes Aktgjykimit *Micallef kundër Maltës*, GJEDNJ kishte ndryshuar dhe konsoliduar qëndrimin e saj të mëparshëm përkitazi me mos aplikueshmërinë e garancive procedurale të nenit 6 të KEDNJ-së në "*procedurat paraprake*". Përmes këtij Aktgjykimi, GJEDNJ (i) sqaroi se marrë parasysh rrethanat kur shumë Shteteve Kontraktuese përballen me një akumulim të konsiderueshëm çështjesh për shkak të mbingarkesës së sistemeve të tyre të drejtësisë, gjë që rezulton në procese të tej-zgjatura gjyqësore, vendimi përkitazi me një masë të përkohshme shpesh ndodhë të jetë i barasvlerëshëm me një vendim për meritat e çështjes, dhe për pasojë shumë herë ndodhë që procedurat për masa të përkohshme të vendosin përkitazi me "*detyrime dhe të drejta civile*" apo të rezultojnë në të njëjtat efekte afatgjata apo edhe të përhershme (shih rastin e GJEDNJ-së *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 79); dhe (ii) përcaktoi kriteret mbi bazën e të cilave duhet të vlerësohet aplikueshmëria e nenit 6 të KEDNJ-së në "*procedurat paraprake*". (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafët 83-86).
68. Për sa i përket kriterëve që duhet të plotësohen në mënyrë që garancitë procedurale të nenit 6 të KEDNJ-së të jenë të aplikueshme, GJEDNJ theksoi se: (i) "*procedura paraprake*" duhet të mbulojë një të drejtë "*civile*" (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 84 dhe referencat e përmenduar aty); dhe (ii) kjo procedurë duhet të përcaktojë në mënyrë efektive të drejtën përkatëse civile (shih, në këtë

kontekst, rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 85 dhe referencat e përmenduara aty).

69. Rrjedhimisht, Gjykata duhet të vlerësojë në vijim, nëse këto dy kritere, janë të përmbushura në rrethanat e rastit konkret, duke mundësuar për pasojë, aplikueshmërinë e garancive procedurale të përcaktuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
70. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një Njoftim të Prokurorit të Shtetit përmes të cilit ishte refuzuar propozimi i parashtrueses së kërkesës për ngritjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër një Akvendim të Gjykatës së Apelit dhe i cili gjithashtu kishte refuzuar ankesën e parashtrueses së kërkesës përkitazi me vendosjen e masës së përkohshme të sigurimit nga Gjykata Themelore dhe e cila do të ndalonte procedurën përbarimore kundër pronës të lënë në hipotekë në lidhje me të cilën ajo pretendon të mos ketë patur njohuri dhe rrjedhimisht ka paditur bashkëshortin e saj dhe ProCredit Bank-ën. Padia e ushtruar nga parashtruesja e kërkesës lidhur më vërtetimin e pronësisë në ngastrën e cila është lënë hipotekë përmes Kontratës mbi Hipotekën, por edhe kërkesa për vendosjen e masës së përkohshme të sigurimit, janë të ndërlidhura me një të drejtë të saj civile, përkatësisht të drejtën e saj në pronë. Për më tepër, qëllimi i masës së përkohshme të sigurimit është që të paktën për një periudhë të caktuar kohore të sigurojë të drejtën civile që kontestohet edhe në procedurë kontestimore përkitazi me meritat e rastit. Për pasojë, Gjykata konstaton se kushti i parë për aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në procedurat përkatëse paraprake është i përmbushur.
71. Gjykata më tej, gjithashtu thekson se, në rrethanat e rastit konkret, masa e përkohshme e sigurimit është përcaktuese për këtë të drejtë, sepse e njëjta është mekanizmi i vetëm i mundshëm për parashtruesen e kërkesës, për të ndaluar shitjen e pronës së kontestuar, përmes mekanizmave të procedurës përbarimore, tashmë të iniciuara nga ProCredit Bank dhe të përcaktuara të paktën përmes Konkluzionit të parë të 1 qershorit 2016 të Përmbaruesit Privat. Gjykata rikujton arsyetimin e GJEDNJ-së në rastin *Micallef kundër Maltës* dhe përmes të cilit gjithashtu kishte vënë theks në faktin se si rezultat i procedurave të tejzgjatura gjyqësore deri në zgjedhjen e meritave të një çështjeje, shumë shpesh është masa e përkohshme, ajo e cila mund të jetë e barazvlefshme me një vendim në merita. Për pasojë, Gjykata duhet të konstatojë se edhe kushti i dytë për aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në procedurat përkatëse paraprake është i përmbushur.
72. Rrjedhimisht, dhe siç është cekur më lart, në vijim Gjykata do të shqyrtoj nëse pretendimet e parashtrueses së kërkesës, në rrethanat e rastit konkret janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës.

II. Përkitazi me paragrafin 2 të Rregullit 39 të Rregullores së Punës

73. Gjykata fillimisht rikujton përmbajtjen e këtij rregulli si në vijim:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

74. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton që në vitin 2011, bashkëshorti i parashtrueses së kërkesës dhe vëllau tij, kishin nënshkruar një Kontratë Kredie dhe një Kontratë Hipoteke. Sipas shkresave të lëndës dhe pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, ajo kishte nënshkruar Kontratën për Kredinë, por jo edhe atë për Hipotekën mbi paluajtshmërinë, në të cilën pronarë formal janë bashkëshorti i saj dhe vëllau i tij, por pronësinë e të cilës ajo gjithashtu e pretendon. Kontrata e kredisë ishte amendamentuar edhe disa herë në vitin 2014 dhe 2015 respektivisht, amendamente këto të cilat ishin nënshkruar edhe nga parashtruesja e kërkesës. Në vitin 2016, duke marrë parasysh që kushtet e kredisë nuk ishin respektuar, ProCredit Banka kishte filluar procedurën përmbarimore kundër marrësve të kredisë përkatëse. Përmbaruesi privat kishte caktuar edhe datën e shitjes së parë publike, datë kjo para të cilës, parashtruesja e kërkesës ngriti padi edhe kundër bashkëshortit të saj edhe ProCredit Bank-ës, duke kërkuar anulimin e Kontratës së Hipotekës dhe vërtetimin e pronësisë së saj mbi parcelën e cila ishte lënë në hipotekë, duke kërkuar gjithashtu vendosjen e masës së përkohshme të sigurimit. Kjo e fundit, fillimisht ishte vendosur nga Gjykata Themelore, por pas kundërshtimit të ProCredit Bank-ës, e njëjta ishte anuluar. Gjykata e Apelit kishte konfirmuar Aktvendimin e Gjykatës Themelore për masën e përkohshme të sigurimit, ndërsa, Prokurori i Shtetit gjithashtu kishte refuzuar propozimin e parashtrueses së kërkesës për iniciimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit. Të gjitha këto procedura ndërlidhen me përcaktimin dhe anulimin e masës së përkohshme të sigurimit, përderisa, procedura kontestimore, bazuar në shkresat e lëndës, është në vazhdim e sipër para Gjykatës Themelore.
75. Parashtruesja e kërkesës para Gjykatës konteston vendimet e autoriteteve publike, përkatësisht Njoftimin [KMLC.nr.09/2018] e 2 marsit 2018 të Prokurorit të Shtetit dhe Aktvendimin [AC. nr. 3538/2017] e 8 dhjetorit 2017 të Gjykatës së Apelit, përmes të cilave ishte konfirmuar Aktvendimi i Gjykatës Themelore për anulimin e masës së përkohshme të sigurimit. Në këtë kontekst, ajo ngre, në thelb, tri pretendime kryesore para Gjykatës. Pretendimi i parë ndërlidhet me (i) të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; pretendimi i dytë me (ii) të drejtën për përdorim të gjuhës të garantuar me nenin 5 të Kushtetutës; dhe, pretendimi i tretë me (iii) të drejtën për barazi para ligjit të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës.
76. Në këtë kontekst dhe fillimisht, Gjykata thekson se neni 5 i Kushtetutës është pjesë përbërëse e Kapitullit I [Dispozitat Themelore] të Kushtetutës në të cilin përcaktohen Dispozitat Themelore mbi të cilat ndërtohet sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës, dhe për rrjedhojë, nuk është pjesë përbërëse e Kapitulli II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] apo III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës, ku përcaktohen në mënyrë eksplicite të Drejtat dhe Liritë Themelore të qytetarëve të Republikës së Kosovës, përfshirë

ato të komuniteteve joshumicë. Bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës, tashmë është konsoliduar parimi i përgjithshëm sipas së cilit, nenet e Kushtetutës të cilat drejtpërdrejtë nuk rregullojnë të drejtat dhe liritë themelore, nuk kanë efekt të pavarur, pasi efekti i tyre vlen vetëm për “*gëzimin e të drejtave dhe lirive*” që garantohen me dispozitat e Kapitullit II dhe III të Kushtetutës. (Shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI136/16, me parashtrues *Vllaznim Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 dhjetorit 2017, paragrafi 40; dhe KI67/16, me parashtruese *Lumturije Voca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 janarit 2017, paragrafi 128 dhe referencat e përmendura aty). Prandaj, neni 5 i Kushtetutës, por as edhe nenet e tjera jashtë Kapitullit II dhe III, nuk mund të zbatohen në mënyrë të pavarur dhe vetanake nëse faktet e çështjes nuk bien në fushën e veprimit e të paktën njëres ose më shumë dispozitave të Kapitullit II dhe III të Kushtetutës e që kanë të bëjnë me “*gëzimin e të drejtave dhe lirive të njeriut*”.

77. Në rrethanat e rastit konkret, duke marrë parasysh që pretendimet e parashtrueses së kërkesës ndërlidhen me të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe rrethanat e rastit ndërlidhen me të drejtën e përdorimit të gjuhës së zgjedhur në procedura gjyqësore, Gjykata do t'i trajtojë pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkelje të nenit 5 të Kushtetutës në lidhje me nenin 31 të Kushtetutës.
78. Në vijim të këtij sqarimi, Gjykata do të shqyrtojë pretendimet e parashtrueses së kërkesës që ndërlidhen me (i) Njoftimin e Prokurorit të Shtetit; dhe (ii) Aktvendimin e Gjykatës së Apelit.
 - (i) *Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Njoftimit [KMLC nr. 09/2018] të 2 marsit 2018 të Prokurorit të Shtetit*
79. Gjykata rikujton se pretendimi më thelbësor i parashtrueses së kërkesës ndërlidhet me (i) mungesën e arsytimit të pretenduar të Njoftimit të kontestuar të Prokurorit të Shtetit; dhe (ii) mos marrjen parasysh të provave dhe dëshmimeve nga i njëjti.
80. Para se të trajtojë të dyja pretendimet veçmas, Gjykata rikujton që praktika e saj gjyqësore njih edhe raste të tjera në të cilat është vlerësuar kushtetutshmëria e Njoftimeve të Prokurorit të Shtetit (shih, në këtë aspekt, rastet e Gjykatës ku, *inter alia*, është vlerësuar kushtetutshmëria e Njoftimit të Prokurorit të Shtetit përmes së cilit nuk është pranuar kërkesa e palëve për ngritje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë në favor të tyre, KI139/13, parashtruese *Zorica Đokić*, Aktvendim për papranueshmëri i 24 mars 2014; KI107/14, parashtruese *Xufe Rracaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2014; KI54/14, parashtrues *Baton Morina*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 gusht 2015; KI111/16, parashtrues *Asllan Zenuni*, Aktvendim për papranueshmëri i 22 majit 2017; dhe KI51/18, parashtrues *Sahit Musa*, Aktvendim për papranueshmëri i 11 qershor 2018). Megjithatë, në asnjërin prej rasteve të lartcekura, nuk është kontestuar Njoftimi përkatës në kontekst të mungesës së vendimit të arsytuar gjyqësor në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

81. Në kontekst të këtij pretendimi për mungesën e arsytimit të Njoftimit të kontestuar të Prokurorit të Shtetit përkitazi me të drejtën e saj për përdorimin e gjuhës në procedura gjyqësore, Gjykata fillimisht i referohet tashmë praktikës të saj të konsoliduar sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; *Tatishvili kundër Rosisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007 e *Merabishvili kundër Gjeorgjisë*, Aktgjykimi i Dhomës së Madhe i 28 nëntorit 2017.
82. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI72/12, me parashtrues *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012; KI22/16, me parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, me parashtrues “*IKK Classic*”, Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, me parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018; dhe KI24/17, me parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim i 27 majit 2019.
83. Në parim, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe ajo e Gjykatës, theksojnë se e drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe se gjykatat duhet “*të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsytet në të cilat ata bazuan vendimin e tyre*”. Megjithatë, ky detyrim i gjykatave nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm.
84. Gjykata megjithatë, dhe për dallim nga rastet e lartcituara, thekson se në rrethanat e rastit konkret kontestohet, përkatësisht pretendohet mungesa e arsytimit të Njoftimit të Prokurorit të Shtetit përmes të cilës është refuzuar propozimi i parashtrueses së kërkesës për ngritjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit. Në këtë kontest, dhe (i) për të konstatuar nëse garancitë procedurale të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së përkitazi me mungesën e vendimit të arsyetuar janë të aplikueshme edhe në rastet e Njoftimit të Prokurorit; dhe nëse po, (ii) për të vlerësuar nëse ky Njoftim është mjaftueshëm i arsyetuar në përputhje me këto garanci, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përkatësisht rastit *Gorou kundër Greqisë* (Nr. 2), Aktgjykim i 20 marsit 2009, praktikë gjyqësore kjo në harmoni me të cilën, Gjykata bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e

Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të bëjë interpretimin e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë.

85. Në këtë aspekt dhe fillimisht, Gjykata thekson se rrethanat faktike të rastit të lartcekur dallojnë nga ato të rastit konkret (për faktet e rastit *Gorou kundër Greqisë* (Nr. 2), shih paragrafët 10 deri më 14 të tij), megjithatë, pretendimet esenciale të parashtrueses përkatëse në këtë rast, ngjashëm si me të parashtrueses së kërkesës në rrethanat e rastit konkret, ndërlidhen me (i) kërkesën e saj drejtuar prokurorit publik për të ngritur një ankesë bazuar në çështje ligjshmërie kundër një vendimi të gjykatës penale të Athinës; dhe (ii) një letër, përkatësisht njoftim i prokurorit publik përmes të cilës, parashtruesja përkatëse ishte njoftuar se kërkesa e saj ishte refuzuar me arsyetimin se: “*Nuk ka bazë ligjore për ankesë në Gjykatën e Kasacionit*”. Parashtruesja përkatëse kishte kontestuar arsyetimin e këtij Njoftimi para GJEDNJ-së, duke pretenduar pikërisht mungesë të një vendimi të arsyetuar gjyqësor në kundërshtim me garancitë e nenit 6 të KEDNJ-së. Në vlerësimin e këtij rasti, GJEDNJ vlerësoi (i) aplikueshmërinë e garancive procedurale të nenit 6 të KEDNJ-së në raste kur kontestohet një Njoftim i Prokurorit; dhe (ii) mjaftueshmërinë e arsyetimit të Njoftimit përkatës. Konstatimi i GJEDNJ-së ishte pozitiv në të dy çështjet, duke mos konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në rrethanat e rastit.
86. Më specifikisht, në vlerësimin e aplikueshmërisë së garancive procedurale të nenit 6 të KEDNJ-së përkitazi me Njoftimet e Prokurorit në lidhje me kërkesat për ngritjen e ankesave në emër të palëve, GJEDNJ theksoi se në parim, për të konstatuar një aplikueshmëri të tillë, duhet të ekzistojë një “*kontest*” në lidhje me një të “*drejtë civile*” të njohur përmes legjislacionit përkatës vendor. GJEDNJ vlerësoi se në rrethanat e rastit përkatës këto kushte ishin plotësuar dhe rrjedhimisht pretendimet përkitazi me mungesën e arsyetimit të Njoftimit të prokurorit publik, hynin në fushëveprimin e nenit 6 të KEDNJ-së. Për më tepër, GJEDNJ në këtë rast, njohu si të drejtë civile, të drejtën e një pale për të kërkuar nga një prokuror publik ngritjen e një ankesë në emër të saj, përkundër faktit që një e drejtë e tillë nuk ishte e përcaktuar specifikisht në legjislacionin grek, por megjithatë ishte e bazuar në një praktikë të konsoliduar gjyqësore. (Shih arsyetimin përkitazi me aplikueshmërinë e nenit 6 të KEDNJ-së në paragrafët 27–36 të rastit *Gorou kundër Greqisë* (Nr. 2)).
87. Megjithatë, në vlerësimin e mjaftueshmërisë së arsyetimit të Njoftimit të prokurorit publik, GJEDNJ morri një qasje më kufizuese duke marrë parasysh rolin diskrecional të prokurorit publik në miratimin ose jo të kërkesave të tilla. GJEDNJ theksoi se një përgjegje pozitive e prokurorit përkatës në rast të kërkesave të tilla rezulton në ankesën e vet prokurorit në lidhje me ligjshmërinë e vendimit të kontestuar; ndërsa një përgjegje negative e tij nënkupton refuzimin për të ngritur një ankesë të tij në lidhje me ligjshmërinë e vendimit të kontestuar. (Shih në këtë kontekst paragrafin 40 të rastit *Gorou kundër Greqisë* (Nr. 2)).
88. Për më tepër, dhe përtej theksimit të kompetencës diskrecionale të prokurorit në miratimin ose jo të kërkesave për ngritjen e ankesave të tilla, GJEDNJ gjithashtu vuri theks në praktikën e saj gjyqësore përmes të cilës ajo kishte

konstatuar se nuk kërkohet arsyetim i detajuar në rastet kur aplikohet një dispozitë specifike ligjore për të refuzuar një ankesë bazuar në çështje ligjshmërie dhe e cila nuk ka mundësi suksesi. (Shih paragrafin 41 të rastit *Gorou kundër Greqisë* (Nr. 2); dhe shih gjithashtu Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 31 dhjetorit 2018 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm (aspekti civil); IV. Kërkesat Procedurale; 7. Arsyetimi i Vendimeve Gjyqësore; paragrafi 340). GJENDJ theksoi se i njeiti parim vlen edhe në rastet kur një prokurori publik i kërkohet nga një palë në një kontest civil ushtrimi i një ankesë në emër të tij. Në këtë kontekst, në rrethanat e rastit përkatës, GJEDNJ kishte konstatuar se arsyetimi i dhënë palës përkatëse përmes Njoftimit të prokurorit publik se “*Nuk ka bazë ligjore për ankesë në Gjykatën e Kasacionit*”, ishte i mjaftueshëm dhe rrjedhimisht, në përputhshmëri me nenin 6 të KEDNJ-së.

89. Marrë parasysh praktikën e shtjelluar gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata thekson se garancitë procedurale të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së janë të aplikueshme në rrethanat e rastit konkret përkitazi me Njoftimin e Prokurorit të Shtetit. Siç është shtjelluar më lart, rrethanat e rastit konkret ngërthejnë një të “*drejtë civile*” dhe gjithashtu edhe një “*kontest*”. Kompetenca dhe kriteret mbi bazën e të cilave mund të ngritet kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nga Prokurori Publik është e përcaktuar në nenin 247 të LPK-së. Për më tepër, përkundër faktit që e drejta e një pale për t’iu drejtuar Prokurorit të Shtetit duke kërkuar ngritjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër një vendimi gjyqësor nuk është specifikisht e përcaktuar përmes dispozitave të LPK-së, ekziston një praktikë e konsoliduar gjyqësore edhe në kontekst të propozimeve/kërkesave të palëve por edhe përgjigjeve të Prokurorit Publik, dhe të cilën, GJEDNJ e ka pranuar si të mjaftueshme për të konstatuar aplikueshmërinë e nenit 6 të KEDNJ-së. (Shih paragrafët 30 deri më 36 të rastit *Gorou kundër Greqisë* (Nr. 2)).
90. Rjedhimisht dhe në vijim, Gjykata do të vlerësojë nëse Njoftimi [KMLC. nr. 09/2018] i Prokurorit të Shtetit është i mjaftueshëm dhe në përputhshmëri me praktikën relevante gjyqësore të GJEDNJ-së përkitazi me një vendim të arsyetuar.
91. Në këtë kontest, Gjykata rikujton arsyetimin e Njoftimit të Prokurorit të Shtetit si në vijim:

“E nderuara Znj. Muslija [parashtruesja e kërkesës],

Zyra e Kryprokurorit të Shtetit, më datë 24.01.2018 ka pranuar propozimin tuaj për iniciimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.651/2017 të datës 23.03.2017 dhe kundër vendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AC.nr.3538/2017 të datës 08.12.2017.

Pas pranimit të propozimit tuaj ne i kemi kërkuar shkresat e lëndës nga Gjykata Themelore në Prizren dhe me datën 01.03.2018 nga Gjykata kemi pranuar shkresat e lëndës dhe pas shqyrtimit të tyre ju informojmë se Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit nuk ka gjetur bazë ligjore të mjaftueshme

nga neni 247, paragraf 1, pika a) dhe b) të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, për të parashtruar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Në lidhje me mosdorëzimit të vendimit të Gjykatës së Apelit në gjuhën tuaj, ju mund t'i drejtoheni Gjykatës Themelore në Prizren me kërkesën që vendimi të ju përkthehet.”

92. Bazuar në arsyetimin e lartcekur të Njoftimit të kontestuar, Gjykata vëren se (i) Prokurori i Shtetit i ka kërkuar shkresat e lëndës nga Gjykata Themelore dhe i ka shqyrtuar ato; (ii) bazuar në pikën a) dhe b) të paragrafit 1 të nent 247 të LPK-së, nuk ka gjetur bazë ligjore për të ngritur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë; dhe (iii) e ka referuar parashtruesën e kërkesën në nevojën për një kërkesë në gjykatën përkatëse për të pranuar vendimin gjyqësor, përkatësisht Aktvendimin [AC.nr.3538/2017] e Gjykatës së Apelit në gjuhën që ajo zgjedh.
93. Bazuar në praktikën relevante gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata konsideron se arsyetimi i dhënë nga Prokurori i Shtetit është i mjaftueshëm. Në mbështetje të këtij konstatimi Gjykata vë theks në (i) natyrën diskrecionale të Prokurorit të Shtetit për të ngritur ose jo një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë; dhe (ii) faktin se neni 247 i LPK-së, përkitazi me kriteret mbi bazën e të cilave mund të ngritet një kërkesë e tillë, janë të qarta dhe specifike.
94. Gjykata më specifikisht vëren se bazuar në paragrafët a) dhe b) të nenit të lartcekur, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të ngritet nga Prokurori i Shtetit për shkak të (i) shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, në qoftë se shkelja ka të bëjë me kompetencën territoriale, po që se gjykata e shkallës së parë e ka nxjerrë aktgjykimin pa seancë kryesore, kurse e ka pasur detyrë ta mbajë seancën kryesore, po që se është vendosur për kërkesën, rreth së cilës kontestimi është në vazhdim, apo në qoftë se në kundërshtim me ligjin, është përjashtuar publiku në seancën kryesore; dhe (ii) për shkak të aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale. Kjo e fundit bazuar në nenin 184 të LPK-së ekziston atëherë kur gjykata nuk e ka zbatuar dispozitën e së drejtës materiale që është dashur ta zbatojë, apo kur dispozitën e tillë nuk e ka zbatuar në mënyrë të drejtë. Ndërsa LPK në paragrafin 2 të nenit 247 specifikisht përjashton mundësinë e ngritjes së kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë nga Prokurori i Shtetit duke u bazuar në kapërcimin e kërkesëpadisë dhe vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike.
95. Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, propozimi i parashtrueses së kërkesës për inicimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë është bazuar në arsyetimin për (i) mosvërtetimin e fakteve nga Gjykata e Apelit përkitazi me mungesën e nënshkrimit të saj në Kontratën e Hipotekës të 2 dhjetorit 2011; dhe (ii) mos dorëzimin e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit në gjuhën boshnjake. Argumenti i parë e që ndërlihet me vërtetimin e gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, është specifikisht i përjashtuar përmes paragrafit 2 të nenit 247 të LPK-së, mbi bazën e të cilit do të mund të ngritej kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nga Prokurori i Shtetit. Ndërsa i dyti, përkatësisht pretendimi për mos dorëzimin e Aktvendimit të kontestuar në gjuhën boshnjake, përderisa përbën bazë për konstatimin e shkeljes esenciale të

dispozitave të procedurës kontestimore bazuar në pikën j) të nenit 182 të LPK-së në rast se kërkesa e palës për përdorimin e gjuhës së vet përgjatë procesit gjyqësor është refuzuar në mënyrë të kundërligjshme nga gjykata përkatëse, e njejta nuk është përcaktuar si bazë mbi të cilën mund të ngritet kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë nga Prokurori i Shtetit bazuar në paragrafin 1 të nenit 247 të LPK-së.

96. Për më tepër, dhe siç është theksuar në arsyetimin e Njoftimit të Prokurorit Shtetit, bazuar në legjislacionin e aplikueshëm, përdorimi i gjuhës e cila nuk është gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës apo nuk është në përdorim zyrtar, në procedurat gjyqësore, është e kushtëzuar nga një kërkesë e palës. Kriteri për një kërkesë të tillë, buron nga kushtëzimi i zbatimit të paragrafit 2 përkitazi me statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose atyre në përdorim zyrtar në çdo nivel të nenit 5 të Kushtetutës në *“pajtim me ligjin”* dhe bazohet në kriteret e përcaktuar në këtë *“ligj”*, e që në rrethanat e rastit konkret, janë Ligji nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve (në tekstin e mëtejme: Ligji për Përdorimin e Gjuhëve) dhe LPK. I pari rregullon përdorimin e gjuhëve në procedurat gjyqësore në nenet 12 deri më 18 të tij, ndërsa i dyti, në nenet 6 dhe 96 deri më 98 të tij. (Shih pjesën tek dispozitat relevante ligjore ku citohen të gjitha këto nene në tërësinë e tyre).
97. Bazuar në këtë rregullativë ligjore, dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, në parim gjykatat zhvillojnë procedurat në gjuhën zyrtare apo në *“gjuhët zyrtare të zgjedhura”* nga palët në procedurat përkatëse. Përkitazi me kategorinë e fundit, përkatësisht *“gjuhën zyrtare të zgjedhur”* nga palët në procedurë, nenet 13 dhe 14 të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, përcaktojnë që, përtej veprimit të gjykatës përkatëse me vetiniciativë në rast se ajo vlerëson se është në interes të përgjithshëm publik, me kërkesën e palës, gjykata duhet të (i) sigurojë pajisjet për përkthim simultan, duke përfshirë dëshmitë e dhëna, nga njëra gjuhë zyrtare në tjetrën; dhe (ii) lëshojë dokumente të cilat kanë të bëjnë me procedurat në *“gjuhën zyrtare të zgjedhur”* për procedurë.
98. Për më tepër, dispozitat e procedurës kontestimore i plotësojnë të drejtat e palëve për përdorimin e gjuhës së tyre në procedura gjyqësore. Përtej garancive të përcaktuara në nenin 6 të LPK-së, Kreu VI në lidhje me Gjuhën në Procedurë, në nenet 96, 97 dhe 98 të tij, në parim, u garanton palëve në procedurë (i) të drejtën të përdorin gjuhën e vet apo gjuhën të cilën e kuptojnë në procedurat para gjykatës; dhe (ii) sigurimin e përkthimit në gjuhën e tyre apo gjuhën që e kuptojnë të të gjitha parashtrësive dhe provave shkresore, në rast se pala paraqet një kërkesë të tillë.
99. Gjykata thekson se vlerësimi i neneve të lartcekura në tërësinë e tyre, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, në parim rezulton se çdo palë ka të drejtë të përdorë gjuhën e zgjedhur në një proces gjyqësor dhe të pranojë shkresat dhe vendimet në po atë gjuhë, nëse ka bërë një kërkesë të tillë. Bazuar në shkresat e lëndës, pretendimet e parashtrueses së kërkesës dhe sqarimeve të Prokurorit të Shtetit, një kërkesë e tillë në nivel të Gjykatës së Apelit nuk është bërë asnjëherë nga parashtrësja e kërkesës.

100. Në këtë kontekst, përtej konstatimit që pretendimet e parashtrueses së kërkesës për mungesën e arsytimit të Njoftimit të Prokurorit të Shtetit nuk qëndrojnë sepse Njoftimi përkatës, bazuar në praktikën gjyësore të GJEDNJ-së, është mjaftueshëm i arsytuar, Gjykata gjithashtu thekson se pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkelje të nenit 5 të Kushtetutës, në mungesë të një kërkesë të saj për përdorimin e gjuhës së saj në procedurat para Gjykatës së Apelit dhe për pranimin e vendimit përkatës në gjuhën e zgjedhur të saj, nuk janë mjaftueshëm të dëshmuara dhe të mbështetura dhe rrjedhimisht janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.
101. Gjykata gjithashtu konsideron që parashtruesja e kërkesës nuk ka dëshmuar dhe mbështetur mjaftueshëm pretendimet e saj përkitazi me mos-marrjen parasysh të provave dhe dëshmive nga Prokuroti i Shtetit në kundërshtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përkatësisht rasteve të cilave parashtruesja e kërkesës iu referohet në mbështetje të pretendimeve të saj, *De Haes dhe Gijssels kundër Belgjikës dhe Tinelly & Sons Ltd dhe të tjerët dhe McElduff dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, respektivisht.
102. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore, është detyrim i parashtruesve të kërkesës për të elaboruar dhe argumentuar lidhshmërinë faktike dhe juridike të rastit të tyre me ato të rasteve të GJEDNJ-së dhe të cilave u referohen në favor të argumenteve të tyre para Gjykatës. (Shih, në këtë aspekt, rastet e Gjykatës, KI48/18, parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës*, Aktgjykim i 4 shkurtit 2019, paragrafët 275-276; KI119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për Papranueshmërisë, i 3 majit 2019, paragrafi 80; dhe KI49/19, parashtrues *Limak Kosovo International Airport S.H.A. "Adem Jashari"*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 10 shtatorit 2019, paragrafi 44). Parashtruesja e kërkesës ka dështuar të bëjë këtë lidhshmëri.
103. Por dhe për më tepër, Gjykata vëren që rrethanat e rasteve të referuara nuk ndërlidhen me rrethanat e rastit konkret dhe rrjedhimisht nuk janë të aplikueshme. Në rastin e parë të cituar më lart, parashtruesit përkatës ishin një editor dhe një gazetar të një gazete të cilët kishin publikuar një artikull që kishte krijuar senzacion në publik meqë fliste për çështje të incestit në Belgjikë dhe ngriste pretendime për shkelje të neneve 6 dhe 10 (Liria e Shprehjes) të KEDNJ-së, por që në asnjë pikë nuk ka lidhshmëri me rastin e tanishëm në shqyrtim. Ndërsa rasti i dytë i cituar më lart, kishte të bëjë procedurat për refuzim të ofrimit të disa kontratave publike në Irlandën e Veriut për parashtruesit e atyre kërkesave të përbashkëta dhe ngriste pretendime për shkelje të neneve 6, 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), 13 (E drejta për zgjidhje efektive) dhe 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së, rrethana të cilat gjithashtu nuk kanë asnjë lidhshmëri me rrethanat e rastit konkret.
104. Gjykata nuk konteston detyrimin e gjykatave të rregullta për të vlerësuar në mënyrë të duhur parashtruesat, argumentet dhe provat e dorëzuara nga palët, detyrim ky që buron nga neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe ligjeve përkatëse procedurale e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së. Gjykata ka shtjelluar parimet e përgjithshme përkitazi me detyrimin e

gjykatave për të vlerësuar në mënyrë të duhur parashtresat, argumentet dhe provat e dorëzuara nga palët, ndër të tjera, në rastin KIO7/18, me parashtrues *Çeliku Rollers sh.p.k.*, Aktgjykim i 20 janarit 2020. Megjithatë, dhe për dallim nga kjo praktikë gjyqësore, Gjykata rithekson se në rrethanat e rastit konkret, pretendimet për mos-shqyrtim të provave dhe dëshmime ndërlidhen me një Njoftim të Prokurorit të Shtetit, dhe i cili, siç u cek më lart, është i mveshur me diskrecionin për ngritjen ose jo të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë varësisht prej vlerësimit përkatës nëse janë përmbushur kriteret e përcaktuara në nenin 247 të LPK-së. Për më tepër që, në rrethanat e rastit konkret, pretendimet e parashtrueses së kërkesës për mos marrjen parasysh të provave të saj në kontekst të procedurave që ndërlidhen me vendosjen e masës së përkohëshme të sigurimit nuk janë të mbështetura me asnjë argument konkret. Gjykata rikujton që meritat e rastit të parashtrueses së kërkesës, sipas shkresave të lëndës, janë në zhvillim e sipër në Gjykatën Themelore.

105. Rrjedhimisht, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh karakteristikat e veçanta të rastit, pretendimet e ngritura nga parashtruesja e kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ajo, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se parashtruesja e kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e saj se Njoftimi i kontestuar i Prokurorit të Shtetit është nxjerrë në shkelje të garancive procedurale për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe se rrjedhimisht këto pretendime janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës.

(ii) Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [AC.nr.3538/2017] të 8 dhjetorit 2018 të Gjykatës së Apelit

106. Gjykata gjithashtu rikujton që parashtruesja e kërkesës konteston edhe Aktvendimin e Gjykatës së Apelit përmes të cilit ishte konfirmuar vendimarrja e Gjykatës Themelore, për tërheqje të urdhërit për masë të përkohëshme të sigurimit që përkohësisht ndalonte shitjen e pronës së lënë në hipotekë. Pretendimi kryesor i parashtrueses së kërkesës në këtë aspekt është mosvërtetimi i faktit nga Gjykata e Apelit se parashtruesja e kërkesës nuk e kishte nënshkruar Kontratën për Hipotekën të 2 dhjetorit 2011. Pretendimi tjetër i parashtrueses së kërkesës ishte se edhe Gjykata e Apelit, krahas Prokurorisë së Shtetit, ka vepruar në kundërshtim me nenin 5 të Kushtetutës, duke mos ia dorëzuar vendimin përkatës në gjuhën e saj dhe duke mos marrë parasysh pretendimet lidhur me mosdorëzimin e vendimit në gjuhën e saj, respektivisht. Lidhur me këtë të fundit pretendim, Gjykata rikujton arsyetimin e saj në paragrafët 94 deri më 100 të këtij Aktvendimi, ku u arrit në përfundimin se parashtruesja e kërkesës asnjëherë nuk ka kërkuar që Aktvendimi në fjalë t'i përkthehet dhe të i dorëzohet në gjuhën e saj. Andaj dhe më tutje, Gjykata do ta konsiderojë këtë pretendim si tashmë të trajtuar dhe nuk do t'i kthehet sërish.

107. Ndërsa lidhur me pretendimin se Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit është nxjerrë si rezultat i vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike,

Gjykata i referohet praktikës të saj të konsoliduar gjyqësore, bazuar në të cilën, pretendime të tilla ngasin çështje ligjshmërie, dhe, për pasojë, nuk bien nën juridiksionin e Gjykatës. Të tillat pretendime ligjshmërie, në parim, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata. (Shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI49/19, parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport SH.A., "Adem Jashari"*, cituar më lart, paragrafi 47; KI56/17, me parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; KI154/17 dhe KI05/18, me parashtrues, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60; dhe KI192/18, parashtruese e kërkesës, *Kompania Kosovare për distribuim dhe furnizim me energji, KEDS Sh.A.*, Aktvendim për papranueshmëri, i datës 16 gusht 2019, paragrafi 49).

108. Gjykata, gjithashtu përmes praktikës së saj gjyqësore, vazhdimisht ka theksuar se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "*shkallës së katërt*", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës: KI49/19, parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport SH.A., "Adem Jashari"*, cituar më lart, paragrafi 48; KI154/17 dhe KI05/18, me parashtrues të kërkesës, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, cituar më lart, paragrafi 61; dhe KI192/18, me parashtruese të kërkesës, *Kompania Kosovare për distribuim dhe furnizim me energji, KEDS Sh.A.*, cituar më lart, paragrafi 50).
109. Për më tepër, Gjykata konsideron se Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit, ka arsyetuar mjaftueshëm vërtetimin e bërë nga Gjykata Themelore, përkitazi me mosekzistimin e kushteve të mëtutjeshme për mbajtje në fuqi të masës së përkohshme të sigurimit, ngase provat e reja kishin treguar se, parashtruesja e kërkesës kishte nënshkruar Kontratën për Kredinë dhe amendmanentet pasuese. Vërtetimin e anulimit të masës së përkohshme të sigurimit, Gjykata e Apelit e kishte arsyetuar si në vijim:

"[...] kanë ndryshuar rrethanat në të cilat është caktuar masa e përkohshme e sigurimit nga ana e kësaj gjykate. Kjo për faktin se gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e të paditurit të dytë ProCredit Bankë janë dorëzuar provat me të cilat është dëshmuar se pala paditëse ka nënshkruar kontratën për kredi pranë të paditurit të dytë, përkatësisht se pala paditëse e kishte dhënë pëlqimin e të paditurit të rendit të parë bashkëshortit të saj për marrjen e kredisë nga ana e të paditurit të rendit të dytë.

Në rastin konkret duke marrë për bazë kontratën për kredi nr. 20-044522 që është e dt. 06.12.2011 si dhe amandamentet e kontratës së pengut nr.20056761 e dt. 28.04.2015 pastaj kontrata e kredisë për biznes nr. 20056761 e dt.28.04.2015, listën e pengut të dt. 28.04/2015, kontratën e kredisë për biznes me nr. 20055493 e dt. 24.11.2014, e të cilat prova gjykata nuk i ka patur kur ka vendosur për masën e përkohshme të sigurimit. Pra tani është vërtetuar se pala paditëse [parashtruesja e kërkesës] me asnjë provë gjatë këtij shqyrtimi në lidhje me kundërshtimin e të paditurit të rendit të dytë kundër aktvendimit për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, nuk ka arsyetuar apo provuar të drejtën e saj subjektive dhe se provat e ofruara nga e njejta në bazë të të cilave gjykata e ka caktuar fillimisht masën e përkohshme të sigurimit, tani bien ndesh me provat e paraqitura nga e të paditurit të rendit të dytë e të cilave prova gjykata u fali besimin e plotë. [...] Bazuar nga të gjitha të dhënat e lart cekura, gjykata e anuloi masën e përkohshme të sigurimit, pasi vlerësoi se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 297.1 pik.a e në lidhje me nenin 306.2 të LPK, andaj kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi [...].”

110. Gjukata, gjithashtu vë theks në faktin që, Aktvendimi i kontestuar i Gjukatës së Apelit, ndërlidhet vetëm me kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme të sigurimit, dhe se pretendimet e parashtrueses së kërkesës përkitazi me meritat e rastit të saj, duke përfshirë edhe vërtetimin e plotë të gjendjes faktike, zhvillohen pavarësisht “*procedurave paraprake*”, përkatësisht atyre që ndërlidhen me masat e përkohshme të sigurimit, bazuar në padinë e parashtrueses së kërkesës të 30 qershorit 2016 dhe e cila, bazuar në shkresat e lëndës, është në procedurë e sipër në Gjukatën Themelore.
111. Rrjedhimisht, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh karakteristikat e veçanta të rastit, pretendimet e ngritura nga parashtruesja e kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ajo, Gjukata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se parashtruesja e kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e saj se Aktvendimi i kontestuar i Gjukatës së Apelit është nxjerrë në shkelje të garancive procedurale për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe se rrjedhimisht këto pretendime janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës.
112. Gjukata ripërsëritë qëndrimin e saj se, pakënaqësia e parashtrueses së kërkesës, në vetvete, me rezultatin e procedurave nga gjykatat e rregullta për sa i takon caktimit të masës së përkohshme të sigurimit dhe anulimit të mëvonshëm të saj, nuk mundet vetvetiu të paraqesë pretendim të argumentueshëm për shkelje të së drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.
113. Në fund, Gjukata gjithashtu rikujton që parashtruesja e kërkesës pretendon edhe shkelje të nenit 24 të Kushtetutës lidhur me të drejtën për “*barazi para ligjit*”, duke theksuar se vendimet e kontestuara kanë shkaktuar “*pabarazi*”

ndërmjet palëve” dhe se Prokurori i Shtetit dhe gjykatat e rregullta nuk kanë pasur qasje “strikte ligjore si ndaj” ndaj parashtrueses së kërkesës, sikur ndaj të paditurës së dytë, përkatësisht ProCredit Bank-ës.

114. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata rikujton praktikën e saj gjyqësore sipas së cilës vetëm përmendja e një neni të Kushtetutës, pa arsyetim të qartë dhe adekuat se si është shkelur ajo e drejtë, nuk mjafton si argument për të aktivizuar makinerinë e mbrojtjes që ofron Kushtetuta dhe Gjykata, si institucion që përkujdeset për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. (Shih, në këtë kontest, rastet e Gjykatës KIO2/18, parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor]*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019, paragrafin 36; dhe KIO5/19, parashtrues *Ruzhdi Bejta*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 tetorit 2019, paragrafët 30-31).
115. Një qëndrim i tillë i Gjykatës, është i bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, bazuar në të cilën, pretendimet apo ankesat e paarsyetuara dhe të pambështetura me argumente e prova, shpallen të papranueshme si qartazi të pabazuara. (Shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 4. Ankesat e paarsyetuara: mungesa e provave, paragrafët 280 deri më 283).
116. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimet për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës dhe për rrjedhojë, këto pretendime duhet të shpallen të papranueshme si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundime

117. Gjykata sqaroi se, objekt vlerësimi para saj ishin vetëm vendimet e gjykatave të rregullta që kishin të bëjnë me “*procedurat paraprake*” për caktim të masës së përkohshme të sigurimit. Gjykata, pas aplikimit të parimeve të përgjithshme që ndërlidhen me aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së në raste që ndërlidhen me “*procedura paraprake*”, konstatoi se nenet e lartcekura janë të aplikueshme në rrethanat e rastit konkret, dhe rrjedhimisht, kërkesa e parashtrueses së kërkesës është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën. Më tej, Gjykata vazhdoi me vlerësimin e pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, për të konstatuar nëse të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.
118. Përkitazi me pretendimet e parashtrueses së Njoftimi i Prokurorit të Shtetit është nxjerrë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata konstatoi se: (i) Njoftimi i Prokurorit të Shtetit ka përmbushur detyrimin kushtetues për të ofruar një vendim të mjaftueshëm të arsyetuar gjyqësor në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së; (ii) pretendimet për mos-shqyrtim të provave dhe dëshmive nga ana e Prokurorit të Shtetit nuk qëndrojnë ngase ky i fundit është i mveshur me diskrecionin për ngritjen ose jo të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë; dhe (iii) vlerësimi i

Prokurorit të Shtetit se parashtruesja e kërkesës ka mundur të kërkojë përkthimin e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit dhe se nuk e ka bërë një gjë të tillë, qëndron. Rrjedhimisht, Gjykata theksoi se këto pretendime janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese në përputhje me paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës.

119. Ndërsa, përkitazi me pretendimet e parashtrueses së kërkesës se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit është nxjerrë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata konstatoi se ajo nuk ka dëshmuar dhe nuk i ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e saj për shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, dhe se rrjedhimisht, të njëjtat, janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese në përputhje me paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20, 47 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullin 39 (2), dhe 39 (3) (b) e 59 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 11 mars 2020, njëzëri:

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- IV. TË DEKLAROJË se ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Gresa Caka-Nimani



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Aziza Rama-Hajrizi